

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“SAMBEL RECRUITMENT AGENCY” SH.P.K.

Sot në Tiranë, më datën 01.06.2024, me cilësinë e ortakëve themelues të shoqërisë:

BRISIDA ADEMAJ lindur më 30.10.1986 në Tiranë dhe banuese në Tiranë, madhore dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës e letërnjoftimit me numër personal I66030048P me cilësinë e Ortakut themelues të Shoqërisë Tregtare “**SAMBEL RECRUITMENT AGENCY**” SH.P.K.

Me nënshkrimin e këtij Akti Themelimi të shoqërisë tregtare, nënshkruesit dhe themeluesit e saj marrin përsipër të realizojnë e të respektojnë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga klauzolat e mëposhtme, të cilat do të specifikohen gjerësisht në Statutin e shoqërisë:

THEMELIMI I SHOQËRISË

Në mbështetje dhe zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar si dhe ligjin nr. 9723 dt. 03.05.2007 “Për Qëndrën Kombëtare të Rregjistrimit”, i ndryshuar themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e emërtuar “**SAMBEL RECRUITMENT AGENCY**” SH.P.K., (më poshtë në këtë akt e quajtur "Shoqëria") nga Ortakët themelues të saj.

FORMA E SHOQËRISË

Shoqëria “**SAMBEL RECRUITMENT AGENCY**” SH.P.K., më poshtë e referuar si “Shoqëria”, është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar krijuar në bazë të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar, dhe rregullohet prej këtij ligji, dhe statutit të shoqërisë si dhe prej cdo dispozite tjetër ligjore të aplikueshme.

II. EMRI I SHOQËRISË, SELIA, OBJEKTI DHE KOHËZGJATJA

EMRI

Emri i shoqërisë është “**SAMBEL RECRUITMENT AGENCY**” SH.P.K. Në cdo dokument, faturë, reklamë dhe publikime emri i shoqërisë do të pasohet nga:

- (i) fjala “me përgjegjësi të kufizuar” apo “sh.p.k”
- (ii) numri i saj i regjistrimit
- (iii) selia

SELIA

Selia administrative e shoqërisë do të jetë në **Rrugën Fadil Hadushaj, Nd.1, H.1, Tiranë.**

KOHËZGJATJA



Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është për një periudhë kohe të pacaktuar, duke filluar prej momentit të regjistrimit të saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

III OBJEKTI I SHOQËRISË

OBJEKTI

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me legjislacionin shqiptar do të jetë:

1. *Ndërmjetësim në tregun e punës vendas dhe të huaj;*
2. *Shërbime rekrutimi dhe zhvendosje;*
3. *Kryerje e shërbimeve administrative për aplikime në e-albania si dhe kryerja e aplikimeve të ndryshme.;*

Përveç veprimtarisë së parashikuara më lart, në veprimtarinë e shoqërisë do të hyjë cdo veprimtari që do të konsiderohet nga Asambleja e Ortakëve si e nevojshme dhe e përshtatshme për arritjen e objektit të shoqërisë dhe që nuk vjen në kundërshtim me legjislacionin Shqiptar.

IV KAPITALI THEMELTAR DHE ORGANIZIMI

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është përcaktuar në shumën 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Kapitali themeltar është i ndarë në 1 kuotë me një vlerë nominale si më poshtë:

Znj .BRISIDA ADEMAJ - 1 KUOTË ME VLERË 100,000 LEKË
OSE E SHPREHUR NË PËRQINDJE:
Znj.BRISIDA ADEMAJ - 100%

ORGANIZIMI

Shoqëria do të drejtohet nga një Administrator. Këtë detyrë do ta kryej për një periudhë prej 5(pesë) vitesh, **Znj.BRISIDA ADEMAJ**, e cila do të ushtrojë të gjitha kompetencat për administrimin e veprimtarisë së përditshme të shoqërisë, për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ose Statuti ia jep shprehimisht Asamblesë së Përgjithshme.

ORTAKU I SHOQËRISË

“SAMBEL RECRUITMENT AGENCY” SH.P.K

BRISIDA ADEMAJ

